## PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PUNËS

### Neni 6
### Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit tëMZSH-së

1. Drejtoria e Përgjithshme drejtohet nga drejtori i përgjithshëmi MZSH-së është në varësi të ministrit përgjegjësdheorganizohet në drejtori dhe sektorë me detyra të ndërlidhura koordinimi, inspektimi, trajnimi dhe logjistike.
2. Drejtori i Përgjithshëm i MZSH-së është përgjegjës për përcaktimin e objektivave dhe detyrave të drejtorive përbërëse, për monitorimin e veprimtarisë të tyre dhe për sigurimin e koordinimit ndërmjet tyre me njësi të tjera të ministrisë.
3. Drejtoria e Përgjithshmee shërbimit të MZSH-së ka për detyrë:
   a) hartimin e rregulloreve për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me standardet ndërkombëtare në fuqi, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave;
   b) hartimin dhe unifikimin e metodologjisë për parandalimin/inspektimin dhe ndërhyrjen shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në nivel vendor;
   c) zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në bashkëpunim me kryetarin e bashkisë, sipas përcaktimit në aktet nënligjore;
   d) bashkërendimin dhe koordinimin e veprimtarisë së stacioneve të MZSH-ve të disa bashkive, për ndërhyrjen me forca, automjete e pajisje zjarrfikëse në rastet e zjarreve masive apo situatave të tjera, për operacione komplekse shpëtimi, që kërkojnë ndërhyrjen e njësive të shërbimit nga disa bashki, në nivel qarku apo më gjerë;
   e) bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimtarisë së shërbimit të MZSH-së me strukturat qendrore të Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura, të Mbrojtjes Civile, Shërbimit të Urgjencës Mjekësore dhe të institucioneve të tjera qendrore, për rritjen e sigurisë publike;
   f) administrimin, përpunimin, analizimin e statistikave për aktivitetin e veprimtarisë së shërbimit të MZSH-së në nivel vendor, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statistikat;
   g) planifikimin dhe organizimin e kualifikimit, trajnimit të personelit të shërbimit vendor të MZSH-së, të personelit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin të objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike dhe të shërbimit vullnetar për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, në Akademinë e Sigurisë dhe qendrat e tjera të sigurisë e të inspektimit;
   h) bashkëpunimin me institucionet, organizmat e tjera ndërkombëtare, shërbimet homologe, subjektet jopublike dhe organizatat joqeveritare;
   i) vlerësimin e dokumentacionit tekniko ligjor për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin të objekteve me rëndësi ekonomiko-strategjike kombëtare dhe të objekteve me rrezikshmëri të theksuar për zjarr dhe shpëtim, parashikuar në ligj dhe akte nënligjore;

j) Inspektimin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga neni 9 dhe neni 40 i ligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin;
k) bashkëpunimin me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF), si autoriteti përgjegjës për aktivitetin e shoqërive të licencuara në fushën e sigurimeve, lidhur me të dhënat e objekteve të siguruara, nga zjarri;
l) raportimin te ministri përgjegjës për përmbushjen e detyrimevenë zbatim të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

**Neni 7**
**Drejtoria e Inspektimit në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së**

1. Drejtoria e Inspektimit në nivel qendror drejtohet nga drejtori dhe i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së.
2. Drejtori i Drejtorisë së Inspektimiështë përgjegjës për zbatimin e objektivave për planifikimin e veprimtarisë dhe realizimin e detyrave të saj, duke dhënë orientime, sipas parimeve të legjislacionit "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe duke monitoruar veprimtarinë e sektorëvedhe personelit përbërës brenda drejtorisë.
3. Drejtoria e Inspektimit është përgjegjëse për:
   a) unifikimin e veprimtarisë sektoriale të inspektimit në nivel vendor;
   b) zbatimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me rregullat e masat parandaluese të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për strukturën inspektuese të MZSH-së në nivel vendor;
   c) hartimin eprojekt rregullorevepër mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me standardet ndërkombëtare në fuqi, të cilat propozohen për miratimnë Këshillin e Ministrave nga ministri përgjegjës;
   d) hartimin eprojekt akteve për unifikimin e metodologjisë për masat e parandalimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit në nivel vendor;
   e) kontrollin e ligjshmërisë në zbatim të detyrimeve ligjore dhe të akteve nënligjore;
   f) kryerjen e kontrollevetë programuara në zbatim tëdetyrimeve të përcaktuara në nenet 9 dhe 40 tëligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin";
   g) mbajtjen, përpunimin, analizimin e statistikave për aktivitetin e veprimtarisë inspektuese/parandaluese të shërbimit të MZSH-së në përputhje me legjislacionin në fuqi për statistikat;
   h) kryerjen e detyrave të tjera, në zbatim të ligjit të shërbimit të MZSH-së dhe legjislacionit në fuqi.

**Neni 8**
**Drejtoria e Koordinimit të Stacioneve të MZSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së**

1. Drejtoria e Koordinimit të stacioneve të shërbimit të MZSH-së në nivel qendror drejtohet nga drejtori dhe i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së.
2. Drejtori i Drejtorisë së Koordinimit të stacioneve të shërbimit të MZSH-së është përgjegjës për zbatimin e objektivave, për planifikimin e veprimtarisë dhe realizimin e detyrave të saj, duke dhënë orientime sipas akteve nënligjore në fuqi, dhe duke monitoruar veprimtarinë e sektorëve dhe personelit përbërës brenda drejtorisë.
3. Drejtoria e Koordinimit të stacioneve të shërbimit të MZSH-së është përgjegjëse për:
   a) hartimin e projekteve për unifikimin e veprimtarisë sektoriale të ndërhyrjes për shpëtimin, shuarjen e zjarreve dhe aksidenteve të tjera, në nivel vendor;
   b) zbatimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me procedurat standarde të ndërhyrjes, për strukturën operuese të shërbimit të MZSH-së në nivel vendor;
   c) bashkërendimin dhe koordinimin e veprimtarisë të stacioneve shërbimit të MZSH-të në nivel vendor midis bashkive dhe urdhëron ndërhyrjen me forca, automjete e pajisje zjarrfikëse të tyre në rastet e zjarreve masive apo situatave të tjera, për operacione komplekse shpëtimi, që kërkojnë ndërhyrjen e njësive të shërbimit nga disa bashki;
   d) bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimtarisë të shërbimit të MZSH-së me strukturat qendrore të Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura, të Mbrojtjes Civile, Emergjencat Civile, Shërbimit të Urgjencës Mjekësore dhe të institucioneve të tjera qendrore, për bashkërendimin e veprimeve ne rritjen e sigurisë publike;
   e) mbajtjen dhe përpunimin e statistikave për aktivitetin e ndërhyrjeve të stacioneve të shërbimit të MZSH-së në përputhje me legjislacionin në fuqi për statistikat;
   f) kryerjen e detyrave të tjera, në zbatim të ligjit të shërbimit zjarrfikës dhe legjislacionit në fuqi.

**Neni 9**

**Drejtoria e Mbështetjes dhe Logjistikës në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së**

1. Drejtoria e Mbështetjes dhe Logjistikës në nivel qendror drejtohet nga drejtori dhe raporton te Drejtori i Përgjithshëm i MZSH-së.
2. Drejtori i Drejtorisë së Logjistikës është përgjegjës për zbatimin e objektivave për menaxhimin e aktiveve të Drejtorisë së Përgjithshme të shërbimit të MZSH-së, të veprimtarisë dhe realizimin e detyrave të saj, si dhe për monitorimin e veprimtarisë të sektorëve dhe personelit përbërës brenda drejtorisë.
3. Drejtoria e Drejtorisë së Mbështetjes dhe Logjistikës është përgjegjëse për:
   a) menaxhimin dhe administrimin e dokumentacionit tëburimeve njerëzore të shërbimit zjarrfikës të nivelit të mesëm dhe të lartë, për emërimin, lirimin, pezullimin dhe përjashtimin e punonjësve të këtyre niveleve të shërbimit vendor të MZSH-së, si dhe administron praktikat disiplinore mbi vlerësimet dhe shkeljet disiplinore të punonjësve të MZSH-së;

b) mbështetjen logjistike të aktivitetit të Drejtorisë/Sektorit të Trajnimeve gjatë trajnimeve, të aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së, kryesisht gjatë nevojave për veprime financiare përpërqendrimin e forcave dhe të mjeteve, si dhe detyrimet e tjera logjistike të shërbimit që rrjedhin nga zbatimi i ligjit për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
c) planifikimin e buxhetit në bashkëpunim me drejtorinë përgjegjëse për financat nëministrinë përgjegjëse, si dhe nëpërpilimin e nevojave, për zbatimin e buxhetit të shërbimit të MZSH-së;
d) kryen detyra të tjera, në zbatim të ligjit të shërbimit zjarrfikës dhe legjislacionit në fuqi.

**Neni 10**
**Drejtoria Trajnimit në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së**

1. Drejtoria eTrajnimit në nivel qendror drejtohet nga drejtori dhe i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të MZSH-së.
2. Drejtori i Drejtorisë së Trajnimit është përgjegjës për zbatimin e objektivave për planifikimin e veprimtarisë dhe realizimin e detyrave të saj, për trajnimin e përditshëm të punonjësve, sipas një programi të hartuar për të gjithë punonjësit e shërbimit të MZSH-së, duke mundësuar dhe synuar një edukim solid, të kombinuar me pajisje teknike profesionale, si dhe për ta bërë këtë shërbim të specializuar një partner të besueshëm në situata emergjente dhe një faktor të domosdoshëm sigurie.
3. Drejtoria e Trajnimit në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së përgjigjet përplanifikimin dhe zhvillimine trajnimeve të specializuara dhe të avancuara, sipas kërkesave të strukturave përkatëse, inspektuese dhe ndërhyrëse, duke zhvilluar definimin e konceptit "Trajnim për strukturat vendore të shërbimit zjarrfikës", si një grup aktivitetesh të mirë strukturuara, të cilat kanë për qëllim informimin, instruktimin, përmirësimine performancës së shërbimit zjarrfikës, si dhe dhënien e ndihmesës në arritjen e njëniveli të caktuar njohurish ose aftësish, si domosdoshmëri për rritjen e sigurisë së komunitetit, nga rreziku i zjarrit apo fatkeqësive të tjera.
4. Drejtoria e Trajnimit në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së përgjigjet për zhvillimin e kapaciteteve të brendshme trajnuese.
5. Drejtoria e Trajnimit të shërbimit të MZSH-sëështë përgjegjëse për hartimin e programeve specifike të trajnimit të strukturave të shërbimit të MZSH-së në nivel vendor, të personelit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin të objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike, strukturave të shërbimit vullnetar për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin në Akademinë e Sigurisë dhe qendrat e tjera të sigurisë e të inspektimit në drejtim të trajnimit në:
   a) fushën e inspektim/parandalimit të masave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
   b) fushën e taktikës së ndërhyrjes se shuarjes së zjarreve dhe ndërhyrjeve të tjera;
   c) përditësimin e mjeteve dhe pajisjeve zjarrfikëse që përdoren për ndërhyrje, shpëtim dhe fikjen e zjarreve;

d) për shpëtimin në njerëzve, pronës, gjësë së gjallë në situata të krijuara nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera;
e) testimin e punonjësve të shërbimit të MZSH-së, për vlerësimin dhe marrjen e gradës pasardhëse;
f) përgatit programin vjetor të trajnimeve për drejtoritë/sektorët vendor të MZSH-së, kontrollon zbatimin e tij dhe realizimin e normave të testimit fizik nga personeli i nivelit operues bazë;
g) mban regjistrin dhe listën emërore të punonjësve të MZSH-së të trajnuar dhe të së drejtës për gradë.

6. Jep asistencë teknike e trajnime në fushën e mbrojtjes nga zjarri, për personat juridikë e fizikë.
7. Organizon stërvitje demonstrative, takime e trajnime me institucione dhe subjekte të ndryshme, për dhënien e njohurive mbi sigurinë nga zjarri.
8. Ndjek programet e përbashkëta trajnuese me vendet e rajonit dhe më gjerë.
9. Kryen detyra të tjera, në zbatim të ligjit të shërbimit zjarrfikës dhe legjislacionit në fuqi.

**Neni 11**
**Sektori i shërbimit të MZSH-së**

1. Sektori është struktura administrative më e ulët e organizimit të brendshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të MZSH-sëdhe është ekskluzivisht përgjegjëse për detyrat që i caktohen shprehimisht, brenda fushës së përgjegjësisë së drejtorive të së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.
2. Sektori drejtohet nga shefi i sektorit, i cili i raporton drejtpërdrejt drejtorit të drejtorisë, pjesë e së cilës është sektori. Shefi i sektorit, në rast mungese apo paaftësie afatshkurtër, zëvendësohet, nga nëpunësi i nivelit më të lartë të njëjtit sektor. Në rast se ka më shumë se një punonjës të njëjtit nivel, ai zëvendësohet nga punonjësi i nivelit më të lartë që ka vjetërsi më të madhe në shërbimin e MZSH-së.

**Neni 12**
**Drejtoria/Sektori i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor**

1. Drejtoria/Sektori i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor është grupim punonjësish me detyra të ndërlidhura dhe është struktura bazë operuese/inspektuese në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në territorin që ka në juridiksion dhe varet administrativisht nga Kryetari i Bashkisë.
2. Drejtoria/Sektori i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor drejtohet nga drejtori/shefi i sektorit të shërbimit të MZSH-së dhe raporton për kryerjen e detyrave dhe misionit te Kryetari i Bashkisë përkatëse, dhe për sa është parashikuar në ligj, apo akte nënligjore raporton tek Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së, në ministrinë përgjegjëse.

3. Drejtoria/Sektori i MZSH-së në nivel vendor është përgjegjës/e për:

a) kompetencat që kanë të bëjnë ekskluzivisht me shuarjen e zjarreve, pakësimin e pasojave që lidhen me to, me asistencën teknike në çdo lloj aksidenti, si dhe mbështetje për shërbimin e ndihmës në raste fatkeqësish;
b) organizimin dhe marrjen e masave për rritjen e gatishmërisë së përhershme të shërbimit të MZSH-së, kompletimin e shërbimit zjarrfikës me pajisje zjarrfikëse, pajisje materialo-teknike, uniforma, automjete zjarrfikëse, plotësimin e kushteve të punës dhe kryerjen e shërbimit, në bashkëpunim me kryetarin e bashkisë;
c) si strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme për të mbrojtur sigurinë e njerëzve dhe integritetin e aseteve, nëpërmjet ndërhyrjeve teknike të karakterizuara nga kërkesa e menjëhershme e performancës dhe profesionalizëm teknik, me përmbajtje të lartë të specializuar dhe burime të përshtatshme instrumentale për shuarjen e zjarreve dhe ndërhyrjeve të tjera, që janë pjesë përbërëse të misionit të shërbimit të MZSH-së;
d) organizon dhe kontrollon masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në objektet në territorin e bashkisë, nëpërmjet kontrolleve të programuara;
e) zhvillimin e stërvitjeve me personelin operues dhe inspektues;
f) zhvillimin e mësimeve treguese në komunitet, për edukimin, promovimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
g) ndjekjen në vazhdimësi të menaxhimit të buxhetit të MZSH-së, furnizimin me karburant, lubrifikantë, filtra, pjesë ndërrimi për automjetet, kërkesat, shpenzimet operative, pagesat, shpërblimet, etj.;
h) bashkëpunimin, koordinimin e veprimeve të strukturave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin me strukturat e tjera operuese dhe inspektuese që veprojnë në territorin e bashkisë;
i) mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të shërbimit të MZSH-së, si dhe përpilimin e statistikave për aktivitetin dhe veprimtarinë e shërbimit në nivel vendor, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
j) koordinimit të veprimeve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin me stacionet e MZSH-së, në objektet me rëndësi ekonomike e strategjike;
k) planifikon dhe paraqet te kryetari i bashkisë kërkesat vjetore, për buxhetin e shërbimit zjarrfikës, menaxhon buxhetin e miratuar, menaxhon të ardhurat që krijon shërbimi zjarrfikës, për rritjen e gatishmërisë së personelit, mjeteve dhe pajisjeve zjarrfikëse, për shpenzime operative dhe investime për këtë shërbim;
l) Drejtori/Shefi i sektorit të MZSH-së në nivel vendor në çdo rast informon kryetarin e bashkisë për veprimtarinë e stacionit, për ndërhyrjet që kryen, për ngjarje të ndryshme që mund të ndodhin në territor;
m) Drejtori/Shefi i sektorit të MZSH-së në nivel vendorpër ngjarje me dëme dhe pasoja njofton në kohë reale, Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së,kryesisht për zjarre masive, fatkeqësi natyrore, apo fatkeqësi të tjera, që ndodhin në territorin e bashkisë;

n) Drejtori/Shefi i sektorit të MZSH-së në nivel vendor dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së informacion me shkrim të përditësuar për aktivitetin që kryen shërbimi dhe çdo datë 3 të çdo muaji pasardhës dërgon me shkresë dhe me e-mailstatistikat mujore të aktivitetit të shërbimit të MZSH-së në nivel vendor;
o) Drejtori/Shefi i sektorit të MZSH-së në nivel vendor, si dhe punonjësit e nivelit te mesëm, largohen nga territori i bashkisë gjatë ditëve të punës vetëm me leje të kryetarit të bashkisë. Në rastet kur largohen jashtë shtetit për arsye të ndryshme pasi marrin leje tek kryetari i bashkisë duhet të njoftojnë edhe Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së.

4. Drejtoria e shërbimit të MZSH-së në nivel vendor si grupim punonjësish me detyra të ndërlidhurapërbëhet nga sektori: i ndërhyrjes, inspektim/parandalimit,mbështetjes, logjistikës.
5. Drejtoria e shërbimit të MZSH-së që gjendet nëbashkinë qendër qarku, realizon koordinimin e forcave të shërbimit zjarrfikës të bashkive që gjenden në territorin e qarkut, për ndërhyrje në zjarret masive, operacioneve komplekse të shpëtimit ku kërkohet pjesëmarrja e stacioneve të tjera të MZSH-së të bashkive brenda një qarku.
6. Drejtoria e shërbimit të MZSH-së në bashkinë qendër qarku, organizon seminare, përgatit analiza të ndryshme mujore, 3 mujore, vjetore, me personelin e nivelit të mesëm të sektorëve të MZSH-se të bashkive jo qendër qarku, për njohjen dhe zbatimin e akteve nënligjore, për zbatimin e normave dhe standardeve të vendosura me të gjitha stacionet e bashkive të qarkut, gjithashtu organizon aktivitete të ndryshme me forcat vullnetare në territorin e bashkive të qarkut.
7. Drejtoria e shërbimit të MZSH-së në bashkinë qendër qarku përbëhet ngasektori i ndërhyrjes, sektori i inspektimit/parandalimit me funksione me gradë,si dhe nga sektori i logjistikës me funksionet administrative.
8. Sektori i shërbimit të MZSH-së në bashkitë jo qendër qarku përmban funksionet me gradë:Shefi i sektorit të shërbimit të MZSH-së, inspektor i parandalimit, (punonjës të nivelit të mesëm), si dhe jo më pak se 12 punonjës të nivelit bazë (ku të paktën 4 nga këta punonjës duhet të jenë drejtues automjetesh të pajisur me leje drejtimi, sipas parashikimeve të Kodit Rrugor).

**Neni 13**
**Sektori i ndërhyrjes së shërbimit të MZSH-së nënivel vendor**

1. Në drejtorinë të shërbimit të MZSH-së në nivel vendor funksionon sektori i ndërhyrjes të këtij shërbimi, i cili është në varësi të drejtorit vendor të MZSH-së.
2. Sektori i ndërhyrjes përbëhet nga punonjësit e stacionit zjarrfikës dhe shefi i sektorit të ndërhyrjes, i cili ka në varësi të drejtpërdrejtë personelin operues të stacionit zjarrfikës.
3. Shefi i sektorit të ndërhyrjes është përgjegjës për detyrat operuese të shërbimit të MZSH-së dhe përgjigjet për gatishmërinë e efektivit, planëzimin e shërbimit 12 ose 24 orësh,

plotësimin e librit tëshërbimit, përgatishmërinë e mjeteve dhe pajisjeve, për zhvillimin e programit të stërvitjes, për rritjen e aftësive profesionale të punonjësve të stacionit.

4. Harton raportin e ndërhyrjes, lidhur me forcat, mjetet, taktikën e përdorur, kostot e ndërhyrjes, dëmin e përafërt të shkaktuar nga zjarri dhe mban statistika për zjarret e rëna/ndërhyrjet.
5. Mban statistika për hartën e sistemit të hidrantëve, numrin e hidrantëve, vendndodhjen e tyre dhe burime të tjera të furnizimit me ujë në territor.
6. Zhvillon çdo muaj stërvitje demonstrative, sipas planeve vjetor të miratuar nga Drejtori i MZSH-së në objekte të ndryshme në territorin e bashkisë, sidomos në objektet sociale, kopshte, shkolla, spitale, objekte që kanë rrezikshmëri të theksuar për zjarr, objekte që kanëgrumbullim të njerëzve, etj.

**Neni 14**

**Sektori i Inspektimit/Parandalimit dhe Inspektori i shërbimit të MZSH-së në nivel vendor**

1. Në drejtorinë vendore të shërbimit të MZSH-së funksionon sektori i Inspektim/parandalimit të këtij shërbimi, i cili varet nga drejtori i drejtorisë të shërbimit të MZSH-së në nivel vendor.
2. Sektori i Inspektimit/parandalimitdrejtohet nga shefi i sektorit, i cili i raporton drejtpërdrejtë drejtorit të drejtorisë. Sektori i inspektimit përbëhet nga punonjës me gradë me funksione: shef i sektorit të inspektim/parandalimit dhe nga inspektorët.
3. Sektori i inspektim/parandalimit në drejtorinë vendore të shërbimit të MZSH-së kryenushtrimin e funksioneve të tij, nëpërmjet akteve dhe veprimeve konkreteadministrative, inspektuese, sipasparimeve dhe përcaktimeve në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përputhje me parimet e legjislacionit“Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
4. Për arritjen e qëllimit për pakësimin e zjarreve, apo risqeve lidhur me to, sektori i inspektimit/inspektorinë strukturën e shërbimit të MZSH-së kryen:
   a) vlerësim të respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit;
   b) unifikimin dhe dokumentimin e praktikave të mira në respektim të kërkesave ligjore, lidhur me zbatimin e rregullave për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin;
   c) këshillim të subjekteve të inspektuar nga punonjësit e MZSH-së, pjesë e strukturës inspektuese në nivel vendor, si dhe zbatimi me korrektësi të kërkesave ligjore, apo nënligjore në fuqi;
   d) urdhëron korrigjimin e shkeljeve të kërkesave ligjore, apo nënligjore për mbrojtjen nga zjarri dhe eliminimin e pasojave që rrjedhin prej tyre;
   e) dhënien e sanksioneve në përputhje me detyrimin e përcaktuar në nenin 50 të ligjit nr.152/2015 “Për Shërbimin Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin”, për shmangien e rreziqeve që mund t’ju shkaktohen interesave publikë dhe interesave të ligjshëm të

personave fizikë e juridikë, parashikuar nga legjislacioni i posaçëm për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin;

f) bllokimin, nëpërmjet aktit të bllokimit, të çdo strukture zhvillimore/ndërtimore kur ajo paraqet rrezik të shtuar për rënie zjarri dhe shpërthimi dhe kur nuk janë zbatuar detyrat e lëna, që përbëjnë shkelje sipas ligjit nr.152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin";

g) ndërprerjen, nëpërmjet aktit të ndërprerjes/pezullimit, aktivitetin që ushtrohet në objekt, kur konstatohet mungesë të sistemeve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, deri në pajisjen objektit/strukturës me këto sisteme;

h) pezullimin, nëpërmjet aktit të ndërprerjes/pezullimit, për një periudhë kohore të përkohshme, aktivitetin që ushtrohet në objekt/strukturë kur konstatohet mangësi e pjesshme të sistemeve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit deri në pajisjen e plotë me këto sisteme;

i) urdhërimin, nëpërmjet aktit të kontrollit, të subjektit të inspektuar për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar një afat të arsyeshëm kohor për këtë qëllim. Në përcaktimin e afatit për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara dhe eliminimin e pasojave të tyre nga subjekti i inspektimit;

j) kontrollin për zbatimin e standardeve dhe rregullave për tregtimin, nga subjektet fizikë e juridikë, të pajisjeve, sistemeve manuale e automatike të sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin;

k) përpilimin elistës dhe evidentimin objekteve subjekt i kontrolleve nga strukturat e shërbimit të MZSH-sënë territorin e bashkisë;

l) bashkëpunimin me shërbimet e Policisë së Shtetit, për përcaktimin e shkaqeve të zjarreve, në cilësinë e ekspertit të MZSH-së, si dhe kur i kërkohet përpilon aktin e ekspertizës për zjarret e rëna;

m) dhënien e asistencës teknike dhetrajnimetë planifikuara nga drejtoria/sektori i shërbimit të MZSH-së;

n) evidentimin erreziqeve tëpritshme dhe sugjerimin e masave parandaluese për mbrojtjen nga zjarri, në zonat dhe objektet me rrezik të shtuar, apo në ato me rëndësi ekonomike e strategjike;

o) mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të kërkuar nga aktet nënligjorë, si dhe kryen detyra të tjera, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

**Neni 15**

**Sektori i mbështetjes dhe logjistikës në drejtorinë e shërbimit të MZSH-së në nivel vendor**

Sektori i mbështetjes në drejtorinë e shërbimit të MZSH-së në nivel vendor është në varësi të drejtorit të drejtorisë dhe përbëhet nga pozicionet: ekonomist, magazinier, arshivist.

Ky sektor është përgjegjës për:

a) mbështetjen financiare dhe logjistike të punës dhe aktivitetit të shërbimit të MZSH-së, si dhe të detyrimeve dhe të drejtave financiare të shërbimit që rrjedhin nga zbatimi i ligjit;
b) evidentimin e aktivitetit financiar dhe logjistik, nevojat, vjeljen e të ardhurave që krijohen, shpenzimin e tyre, zbatimin e buxhetit të MZSH-së, zbatimin e fondit të pagave, të listë pagesave, të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pagesave të ndryshme që i përkasin personelit të MZSH-së, normativat e harxhimit të karburantit, lubrifikanteve, të dhënat e nevojshme për blerjet e vogla, rakordimet në fund të çdo muaji, gjendjen e magazinës dhe kontabilitetit, etj.;
c) administrimin e dokumentacionit që normon veprimtarinë e shërbimit të MZSH-së, në përputhje me afatet e parashikuara nga dispozitat e ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat", i ndryshuar;
d) menaxhimin e burimeve njerëzore të shërbimit, kryesisht të nivelit bazë, (dosjet përkatëse të tyre) për emërimin, lirimin, pezullimin dhe përjashtimin e punonjësve të këtij niveli, si dhe administron praktikat disiplinore mbi vlerësimet dhe shkeljet disiplinore të punonjësve të MZSH-së në bashkëpunim me njësinë e burimeve njerëzore të bashkisë;
e) administron dokumentacionin që aplikohet në zbatim të ligjit nr.10142, datë 15.5.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
f) kryerjen e detyrave të tjera, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

**Neni 16**
**Stacioni i MZSH-së**

1. Stacioni zjarrfikës është pjesë e infrastrukturës operuese dhe inspektuese të shërbimit të MZSH-së, që vepron në një territor të caktuar, kompletuar me personel zjarrfikës, automjete dhe pajisje zjarrfikëse, për ndërhyrjen në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin, si dhe në rast aksidenti apo fatkeqësie.
2. Çdo grup i gatshëm i punonjësve të shërbimit të MZSH-së në stacionin zjarrfikës në nivel vendor me marrjen e sinjalit të alarmit, ka si kohë reagimi **40 sekonda**, gjatë kohës ditore dhe**1 minutë gjatë natës**, të dalë nga stacioni dhe të adresohet drejt vendit të ngjarjes.
3. Stacioni i MZSH-së, në parim ndërtohet/stacionohet sa me pranë qendrës urbane, në pozicion të tillë që të mbërrijë në çdo objekt të qytetit për jo më shumë se **8 minuta** dhe të ofrojë shërbimine njësisë vendore jo më vonë se **30 minuta**, por duke konsideruar edhe largësinë e vendngjarjes nga stacioni.
4. Drejtues i drejtpërdrejtë i stacionit zjarrfikës është shefi i sektorit, ose komandanti i stacionit kur mungon ky i fundit.
5. Stacioni i shërbimit të MZSH-së ngrihet në çdo bashki sipas standardit 1 zjarrfikës profesionist për 1500-2000 banorë.

6. Stacioni i shërbimit tëMZSH-së është i përbërë nga punonjësit:
   a) punonjës me gradë në funksione (komandant shërbimi, luftues-shpëtues, drejtues mjeti, evakues, furnizues);
   b) punonjës profesionist dhe vullnetar;
   c) zjarrfikës vullnetar.
7. Në njësitë e vetëqeverisjes vendore funksionojnë disa stacione të shërbimit të MZSH-së, në varësi të numrit të popullsisë, shtrirjes territoriale, infrastrukturës, problematikave dhe ngjarjeve të regjistruara, etj. Shpërndarja e stacioneve të shërbimit të MZSH-së në bashki bëhet e studiuardhe me orientim të Drejtorisë së Përgjithshme të shërbimit të MZSH-së.
8. Për përballimin e situatave të veçanta, gjatë sezoneve turistike, situatave emergjente, zjarreve në pyje, nevojave të gatishmërisë, etj., me urdhër të kryetarit të bashkisë ngrihen dhe funksionojnë stacione provizore të shërbimit të MZSH-së.
9. Stacione të shërbimit të MZSH-së ngrihen edhe në objekte me rëndësi ekonomike e strategjike në shkallë vendi, në porte, aeroporte, tunele, në zonat e mbrojtura natyrore, linja magjistrale të transportit të gazit e të karburanteve, apo subjekte te ndryshme private. Këto stacione janë në varësi të subjekteve që kanë në pronësi apo administrim këto objekte. Subjektet që i kanë në pronësi apo përgjegjësi administrimi këto objekte, zbatojnë legjislacionin në fuqi, normat teknike dhe standardet ndërkombëtare në fushën e MZSH-së, në kompletimin e tyre me automjete dhe pajisje speciale zjarrfikëse, duke bashkëpunuar me shërbiminzjarrfikës vendor dhe atë qendror.
10. Në bashki krijohet shërbimi vullnetar për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, në përputhje me kriteret e ligjit nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, i cili bëhet pjesë e shërbimit të MZSH-së në nivel vendor.
11. Struktura, uniforma dhe shenjat dalluese të veçanta, të punonjësit të shërbimit vullnetar të MZSH-së, miratohen me vendim të këshillit bashkiak, pasi konsultimit me Drejtorinë e Përgjithshme të shërbimit të MZSH-së.
9. Standardi minimal për funksionimin e një stacioni zjarrfikës është: 1 automjet zjarrfikës dhe jo më pak se 14 punonjës personel të ndarë sipas funksioneve: 2 punonjës të nivelet të mesëm (shef sektori, inspektor parandalimi), si dhe 12 punonjës të nivelit bazë (ku të paktën 4 nga këta punonjës duhet të jenë drejtues mjeti profesionist, ku çdo turn shërbimi ka jo më pak 3 punonjës).
10. Një stacion zjarrfikës me personel prej 14 punonjësish duhet të jetei pajisur minimalisht me inventarët:
    a) 1 automjet zjarrfikës me kapacitet jo më pak se 2500 Lujë dhe 250 L shkumë;
    b) 1 motopompëzjarrfikëse;
    c) kompletimin me setin e pajisjeve zjarrfikëse, pajisje të ndryshme shpëtimi, për automjetin dhe stacionin zjarrfikës;
    d) uniforma zjarrfikëse për tëgjithë personelin, kushte normale për kryerjen e shërbimit.
    e) instalimin e nr.telefonit fiks 128;
    f) radio-ndërlidhje.

11. Një stacion zjarrfikës, në bashkitë qendër qarku duhet të jetë i pajisur minimalisht me inventarët:
    a) 1 automjet për ndërhyrje me kapacitet deri 500 L ujë,i kompletuar me pajisjet zjarrfikëse, kundra kimike, elektrike, hidraulike, pajisje prerëse/hapëse të shpëtimit, etj.
    b) 2 automjete zjarrfikëse me kapacitet jo me pak se 2000 L ujë dhe 200 L shkumë;
    c) 1 automjet që ka të instaluar sistemin e komandimit në raste incidentesh;
    d) 1 automjet shpëtimi tipi autoshkallë;
    e) pajisje te ndryshme zjarrfikëse rezervë, (tuba të ndryshëm, hedhëse, lidhëse, qafëpatë, çelësa të ndryshëm hidranti, përzierësi i shkumës, shkumë, fiksezjarri të ndryshëm portativë të tipit të përshtatshëm, jastëk ajri, dyshek shpëtimi, pajisje shpëtimi të ndryshme, lloje shkallësh të ndryshme, etj.;
    f) garazhe për automjete me lartësi 4 m, gjatësi jo me pak se 10 m, si dhe me gjerësi jo me pak se 5 m;
    g) garazhet duhet të jenë të pajisura me tuba shkarkimi të posaçme të lidhura me skapamentot për shkarkimin e gazrave të automjeteve jashtë garazhit. Garazhi duhet të ketë të instaluar karikuesin automatik të baterive për çdo automjet;
    h) stacioni duhet të jetë i pajisur me të gjitha ambiente normale për funksionimin e shërbimit, dhomë informacioni operuese, sistem alarmi, tualet, zyra, magazinë, ofiçinë, sallë trajnimi, ambiente ndenjeje, etj.;
    i) stacioni duhet të ketë një shesh para garazheve me sipërfaqe jo me pak se 20x20 m, të asfaltuar, për manovrimin e automjeteve zjarrfikëse, si dhe kullëstërvitje.
12. Stacionet zjarrfikëse kompletohen dhe përdorin pajisjet zjarrfikëse të standardit **“**STROZ”.Ky standard është i detyruar të përdoret edhe nga subjektet shtetërorë, private, në kompletimin e objekteve të tyre me hidrantë të brendshëm apo të jashtëm dhe pajisje të tjera të mbrojtjes nga zjarri.
13. Stacionet zjarrfikëse të objekteve me rendësi ekonomike, strategjike, përveçstandardeve tëmësipërme kompletohen me automjete, personel, pajisje zjarrfikëse duke iu përshtatur veprimtarisë specifike për të cilën ato janë krijuar.